

Alternativa 2 për këshillim Publik për RLAH Shqipëri-Kosovë

Në përcaktimin e afateve për aplikimin e modelit RLAH si dhe kohëzgjatjen e modelit RLAH+ (periudhën tranzitore), AKEP dhe ARKEP duke marrë në konsideratë:

- mënyrën e aplikimit në BE të modelit RLAH;
- draft-marrveshjen e RRA për aplikimin e modelit RLAH në 6 vendet e WB6 (ku përshihen dhe RSH dhe RK), si dhe
- tarifatat aktuale me shumicë dhe me pakicë të roamingut midis RSH dhe RK,

kanë rënë dakort që në propozimin për këshillim publik të përfshijnë 2 alternativa të mundshme të aplikimit të modelit RLAH midis dy vendeve:

Alternativa 1: RLAH duke filluar nga 1.07.2021

- Duke filluar nga data 1.07.2021 të aplikohet modeli RLAH;
- Në periudhën 1.07.2019-30.06.2021 të aplikohet modeli RLAH+;
- Tarifatat me shumicë do të rregullohen sipas vlerave dhe afateve të përcaktuara më poshtë në Tabela 4.1 (si në mërrveshjen RRA WB6 por me disa ndryshime të vogla), dhe këto tarifa me shumicë përbëjnë tavane për tarifatat shtesë me pakicë të RLAH+.

TABELA 4.1: TARIFAT MAKSIMALE ME SHUMICË PËR SHËRBIMET E RREGULLUARA TË ROAMINGUT SHQIPËRI-KOSOVË: ALTERNATIVA 1

Modeli Tarifimit të Roamingut ne Retail	Data e fillimit	Thirrjet e rregulluara roaming (€/min)	Terminimi I Thirrjeve të lidhura me roamingun (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/GB)
		(1)	(2)	(3)	(4)
RLAH+	15 Qershor 2019	0.050	0.040	0.02	10.0
	01 Korrik 2020	0.050	0.025	0.02	7.7
RLAH	1 Korrik 2021	0.032	0.016	0.01	6.0
	1 Korrik 2022	0.032	0.016	0.01	4.5
	1 Korrik 2023	0.032	0.016	0.01	3.5
	1 Korrik 2024	0.032	0.016	0.01	3.0
	1 Korrik 2025	0.032	0.016	0.01	2.5

Shënim: Tarifatat në euro, pa TVSH.

Alternativa 2: RLAH duke filluar nga 1.07.2020

- Duke filluar nga data 1.07.2020 të aplikohet modeli RLAH;
- Në periudhën 1.07.2019-30.06.2020 të aplikohet modeli RLAH+;
- Tarifatat me shumicë do të rregullohen sipas vlerave dhe afateve të përcaktuara më poshtë në Tabela 4.2 (si alternativa 1 por duke përsheptuar me 1 vit), dhe këto tarifa me shumicë përbëjnë tavane për tarifatat shtesë me pakicë të RLAH+.

TABELA 4.2: TARIFAT MAKSIMALE ME SHUMICË PËR SHËRBIMET E RREGULLUARA TË ROAMINGUT SHQIPËRI-KOSOVË: ALTERNATIVA 2

Modeli Tarifimit të Roamingut ne Retail	Data e fillimit	Thirrjet e rregulluara roaming (€/min)	Terminimi I Thirrjeve të lidhura me roamingun (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/GB)
		(1)	(2)	(3)	(4)
RLAH+	15 Qershor 2019	0.050	0.025	0.02	7.7
RLAH	1 Korrik 2022	0.032	0.016	0.01	6.0
	1 Korrik 2021	0.032	0.016	0.01	4.5
	1 Korrik 2022	0.032	0.016	0.01	3.5
	1 Korrik 2023	0.032	0.016	0.01	3.0
	1 Korrik 2024	0.032	0.016	0.01	2.5

Shënim: Tarifatat në euro, pa TVSH.

Propozimi për Alternativën 2 mbështetet në faktin se tarifatat me shumicë dhe me pakicë të roamingut të aplikuara aktualisht në mënyrë komerciale nga operatorët mobilë të dy vendeve (RSH dhe RK) janë ndjeshëm më të ulëta se ato të imponuara nga marrveshja RRA WB6. Aplikimi më shpejt në kohë i RLAH (1.07.2020) midis RSH dhe RK në krahasim me 1.07.2021 i rënë dakort në RRA WB6 është më se i arritshëm nga operatorët mobilë në të dy vendet dhe nuk përbën barrë të rëndë jo-proporcionale për ta.

Mundësia për të aplikuar RLAH+ për një periudhë rreth 1 vjecare është e majftueshme për operatorët që të përshasin modelet e tyre të tarifimit për të aplikuar RLAH nga 1.07.2020 midis RSH dhe RK.